



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 131, Datë 02.07.2024

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“ACHELO” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1534/1 prot., datë 27.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ACHELO” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1534 prot., datë 20.06.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Kotorri”, me kapacitet prodhues 1.9 MW, me vendndodhje në pjesën fundore të përroit të Seltës, degë e lumit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “ACHELO” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin/informacione në zbatim të nenit 9 të Rregullores për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “b” dhe “c”; për pikën 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Të depozitohen vërtetimet e gjendjes gjyqësore për administratorin dhe shoqërinë me afate të rifreskuara sipas rregullores së licencimit (neni 8, pika 3).

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”**: Të depozitohet vërtetimin nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan që nuk ka detyrime të papaguara lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- Shoqëria ka depozituar në ERE VNM Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. AN160820220002, datë 14.09.2022, Komisioni 61, me afat vlefshmëri deri më datën 14.09.2024. Si e tillë shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion nëse ka filluar punimet.
 - Në kuptim të këtij neni (neni 9, pika 1.3, gërma b dhe c), shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion në zbatim të rregullores së licencimit për mbështetjen financiare, por duhet të sqarohet nga ana e saj mënyra e kthimit të huasë së marrë nga ortakët e vetë shoqërisë pasi nuk është specifikuar mënyra e kthimit të kësaj shume. Gjithashtu duhet të saktësohet nga ana e shoqërisë nëse plani i biznesit do të pësojë ndryshime në lidhje e në kuptim të mënyrës së financimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “KOTORRI”, me kapacitet prodhues 1.9 MW, me vendndodhje në pjesën fundore të përroit të Seltës, degë e lumit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI